



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.794/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevcu kryesues, Afijete Sada Gillogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e paraqitur nga Mentor Ferizi dhe Basri Menxhiqi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**I. Pranohet** pjesërisht i bazuar apeli: A.nr. 794/2021, i paraqitur nga Mentor Ferizi dhe Apeli Anr.795/2021 i paraqitur nga Bastri Menxhiqi, të dy nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë, kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për kandidatët për Kuvend Komunal në Vushtri, në këto Vendvotime:

2706B/01R, 2708B/01R, 2702B/01R, 2711B/01R, 2712B/03D, 2712B/03D, 2713B/02R, 2714B/03R, 2717B/01R, 2721B/02D, 2730B/01R

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në vendvotimet e cituara si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

**IV. Refuzohet e** pabazuar pjesa tjetër e apelit lidhur me kërkesën për rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimet 2701B/08R, 2713B/01R, 2717B/02R, 2728B/01D, 2730B/02R (ky VV nuk ekziston, duhet të jetë 2730B/02D).

### A r s y e t i m

PZAP-i, më datën 04.11.2021 ka pranuar apelin Anr.794/2021, të paraqitur nga Mentor Ferizi, dhe apelin Anr.795/2021 të paraqitur nga Basri Menxhiqi, nga subjekti politik Partia

Demokratike e Kosovës (PDK), kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë, të cilët pretendojnë se ka shkelje të procedurave të numërimit të votave dhe regjistrimit të tyre në Formularë të Kandidatëve për Kuvendin Komunal të Vushtrrisë, të cilat kanë të bëjnë me mospërputhjen e votave për bartësin e listës për subjektin politik me numrin e votave të kandidatëve të po të njëjtit subjekt politik në këto vendvotime si me poshte.

-Në VV 2706b/01R, të gjitha votat për kandidatët e subjektit politik PDK janë 29, kurse subjektin ka 57 vota, d.m.th. dallimi 2 vota,

-Në VV 2708/01R të gjitha votat për kandidatët e subjektit politik PDK janë 84, kurse subjekti ka 83 vota, d.m.th. dallimi 1 vota,

-Në VV 2701b/08R, të gjitha votat për kandidatët e subjektit politik LDK janë 102, kurse subjekti ka 97 vota, d.m.th. dallimi 5 vota,

-Në VV 2701b/08R, të gjitha votat për kandidatët e subjektit politik NISMA janë 20, kurse subjekti ka 14 vota, d.m.th. dallimi 6 vota,

-Në VV 2702b/01R, të gjitha votat për kandidatët e subjektit politik AAK janë 16, kurse subjekti ka 11 vota, d.m.th. dallimi 1 vota,

-Në VV 2711b/01R, të gjitha votat për kandidatët e subjektit politik LVV janë 76, kurse subjekti ka 75 vota, d.m.th. dallimi 1 vota,

-Në VV 2712b/03D, të gjitha votat për kandidatët e subjektit politik LDK janë 74, kurse subjekti ka 73 vota, d.m.th. dallimi 1 vota,

-Në VV 2712B/03D, të gjitha votat për kandidatët e subjektit politik PDK janë 62, kurse subjekti ka 57 vota, d.m.th. dallimi 5 vota,

-Në VV 2713b/01R, të gjitha votat për kandidatët e subjektit politik NISMA janë 8, kurse subjekti ka 9 vota, d.m.th. dallimi 1 vota,

-Në VV 2713b/02R, të gjitha votat për kandidatët e subjektit politik LDK janë 55 kurse subjekti ka 53 vota, d.m.th. dallimi 2 vota,

-Në VV 2714b/03R, të gjitha votat për kandidatët e subjektit politik LVV janë 43 kurse subjekti ka 42 vota, d.m.th. dallimi 1 vota,

-Në VV 2717b/01R, të gjitha votat për kandidatët e subjektit politik LDK janë 157 kurse subjekti ka 156 vota, d.m.th. dallimi 1 vota,

-Në VV 2717b/02R, të gjitha votat për kandidatët e subjektit politik LDK janë 82 kurse subjekti ka 77 vota, d.m.th. dallimi 5 vota,

-Në VV 2721b/02D, të gjitha votat për kandidatët e subjektit politik AAK janë 82 kurse subjekti ka 77 vota, d.m.th. dallimi 3 vota,

-Në VV 2728B/01D, të gjitha votat për kandidatët e subjektit politik AAK janë 6 kurse subjekti ka 4 vota, d.m.th. dallimi 2 vota,

-Në VV 2730b/01R, të gjitha votat për kandidatët e subjektit politik LVV janë 39 kurse subjekti ka 38 vota, d.m.th. dallimi 1 vota,

-Në VV 2730b/02R, të gjitha votat për kandidatët e subjektit politik LVV janë 39 kurse subjekti ka 28 vota, d.m.th. dallimi 5 vota,

Apeluesi Mentor Ferizi ka bashkangjitur në apel edhe disa deklarata të votuesve të cilët kanë votuar për të njëjtin, më tutje thekson se sipas deklaramit të vëzhguesit në VV 2706b/02D, ka pasur 8 vota ndërsa në formularë nuk figuron asnjë votë. Për këto arsye pretendojnë ankuesit që ankesat e tyre të aprovohen si të bazuara dhe ti urdhërohet KQZ-së që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet e kandidatëve për Kuvendin Komunal të Vushtrrisë.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, i ka bashkuar apelet e lartcekura dhe të njëjtat i trajton si një apel, të evidentuar me Anr.794/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve për çka të gjitha i vendosi me një vendim për hire të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, pas shqyrtimit të pretendimeve të apelit, materialit zgjedhor dhe provave që gjinden në shkresat e lëndëve, gjeti se:

- **apeli është pjesërisht i bazuar.**

Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, pasi që, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe nga hetimi i bërë në materialet zgjedhore, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja, me provat e ofruara nga pala ankuese.

Vet fakti se me verifikim të pretendimeve të ankuesit, në provat e bashkangjitura ankesës, del se në VV e përmendura në pikën II të dispozitivit ka mospërputhje në mes të votave të kandidatëve të një subjekti politik dhe të vet subjektit politik (numri i votave duhet të jetë i barabartë, i kandidatëve dhe i vet subjektit politik), do të thotë se janë bërë numërime të gabuara dhe evidentim i gabuar i këtyre votave në FRK, ashtu siç pretendohet në apelet e lartpërmendura, gjë që tregon se rezultati përfundimtar i shpallur nga KQZ-ja, vërtetë del i pasaktë i cili rezultat i pa sakte me bazë dhe argumente e prova të cilat gjenden në shkresa të lëndës, edhe sipas vlerësimit të PZAP-së, është bazë e mjaftueshme për rinumërim ashtu siç është vendosur me këtë vendim. PZAP gjen se, përveç tjerave, me rinumërim, askujt nuk i cenohet rezultati real dhe i vërtetë, përkundrazi për secilin kandidat për kuvend komunal del rezultat zgjedhor më i sigurt dhe i pranueshëm nga të gjithë.

Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për Kuvend Komunal në Vushtri në lartcekura dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve, të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilën dispozitë përcaktohet se: *“Procedurat e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi, andaj PZAP, nga këto arsye dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Apelet e ankuesve të lartpërmendur u refuzuan përkitazi me kërkesën për rinumërim në VV të përmendura në pikë IV të dispozitivit, pasi që sipas evidencës zyrtare të KQZ-së të gjitha fletëvotimet në këto VV, për të gjithë kandidatët janë rinumëruar dhe nuk mund të rinumërohen edhe një here. Sa i përket VV 2730B/02R, sipas evidencës në KQZ, nuk ekziston, sigurisht duhet të jete fjala për VV 2730B/02D I cili tani me është rinumëruar.

Prandaj me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
A nr. 794/2021 më datën 06.11.2021



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.